



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:227543

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05574504

P.nr.54/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Novobërdë, pë mes gjyqtarit **Sadri Krasniqi**, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të akuzuarit, A. H. nga fsh. Hajvali, Komuna e Prishtinës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av.Kadri Sylaj, për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370, paragrafi 8, lidhur me paragrafin 6 dhe 1 KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1560/2023, të datës 31.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më 18.03.2024, në prani të Prokurores së shtetit, të akuzuarit, dhe mbrojtësit, shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 15.04.2024, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I a k u z u a r i :

**Arsim Hysenaj**, pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm, nga i ati N. dhe e ëma H. e lindur J., i lindur më datë 06.12.1979, në fshatin Petrov, Komuna e Shtimes, tani me vendbanim në Hajvali rr. "Bedri Mustafa", nr.16, me nr. personal 1014109095, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, sipas deklaratës së tij nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

#### Ë s h t ë f a j t o r

#### Sepse:

Me datën 16.09.2023, rreth orës 21:30 minuta, në rrugën Gjilan- Prishtinë, më saktësisht në në hyrje të fshatit Parallovë, Komuna e Novobërdës, i pandehuri A. H., nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik duke e vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre,

ashtu që duke e drejtuar automjetin e tij për pasagjer “Taxi” të markës “Skoda-Karoq”, me targa të regjistrimit 01-443-NA, ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore, neni 53 parag.1 i Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit rrugor të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që duke mos e përshtatur shpejtësinë e automjetit të tij, kushteve të rrugës, rrugë me kthesa, kohë me shi, humbë kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe duke ju bartur, kalon në shiritin e majtë të rrugës ku me pjesën e parë të anës së majtë godet anën e majtë automjetin për pasagjer të markës “Opel-Vectra”, me targa të regjistrimit 06-264-FD, të cilin po e drejtonte i dëmtuari N. I., dhe nga ky aksident i komunikacionit, përpos dëmeve materiale të shkaktuara në automjet, lëndime të rënda trupore pësojnë të dëmtuarit, N. I., dhe F. I. ndërsa N.I., pëson lëndime të lehta trupore të cilët si pasojë e lëndimeve, kërkojnë ndihmë në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, ndërsa N. I. dhe F. I., ndalen në repartin e Ortopedisë në Spitalin Regjional të Gjilanit, për trajtim të mëtutjeshëm.

-me çka ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-ës,

Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 42, 44, 69, 70, 71 dhe 72, paragrafi 1, pika 1.6 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364,449 dhe 452 të KPPRK-së, të akuzuarin A. H. e,

## G J Y K O N

Me dënim burgu efektiv në kohëzgjatje prej nga **katër (4) muajve**, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së do t’i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej **800 €**, të cilën shumë, do ta arkëtoi në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, **në këste mujore**, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do t’i llogaritet nga një ditë burgu.

Në bazë të nenit 59, paragrafi 2, pika 2.5 dhe neni 64 të KPRK-së, të akuzuarit A. H., i shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit në territorin e Republikës së Kosovës, në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, koha e kaluar në burg nuk i llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi .

Të dëmtuarit: N. I., F..I dhe N.I., të gjitha nga fshati Llabjan, komuna e Novobërdës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari detyrohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1560/2023, të datës 31.10.2023, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit A. H.. nga fshati Hajvali, komuna e Prishtinës, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për datë 18.03.2024, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit deklaroi se e pranon fajësinë.

Prokurorja shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, njëherit thekson se janë plotësuar kushtet për pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me këtë veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktit akuzues.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, edhe atë pas konsultimit me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari A.H., nga pakujdesia e ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën veprën penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar në administrimin e provave të tjera, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokuroja e shtetit Kujtesa Fazliu, në fjalën përfundimtare deklaron: se në shqyrtimin e sotëm fillestar i pandehuri A. H. e pranoj fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, në konsultim me mbrojtësin e tij, pranimin e fajësisë i njëjti e bëri vullnetarisht pa ndikim të dhunës, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban. Andaj kërkon nga gjykata që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të njëjtin ta dënojë me dënim të paraparë me ligj, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale, të cilat janë të cekura në aktakuzë, gjithashtu i propozon gjykatës që ndaj të njëjtit të i shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit, ashtu siç është propozuar në aktakuzë.

I dëmtuari N. I., në fjalën përfundimtare deklaron, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit sepse i njëjti është interesuar për gjendjen e tyre shëndetësore, ndërsa e rezervon të drejtën për parashtrimin e kërkesës pasurore juridike.

I dëmtuari F.I., në fjalën përfundimtare deklaron, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, ndërsa e rezervon të drejtën për parashtrimin e kërkesës pasurore juridike.

I dëmtuari N.I., në fjalën përfundimtare deklaron, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, ndërsa e rezervon të drejtën për parashtrimin e kërkesës pasurore juridike.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të akuzuarit, av.Kadri Sylaj, në fjalën përfundimtare deklaron se në cilësinë e mbrojtësit, sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike nuk dua të them asgjë pasi që me vet pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, gjendja faktike është vërtetuar. Si mbrojtës i të akuzuarit i prozon gjykatës që me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje penale, të merren parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë: pranimi i fajësisë, faktin se i akuzuari është interesuar vazhdimisht për gjendjen shëndetësore të

të dëmtuarve, të cilët i ka vizituar disa herë dhe të dëmtuarit për këtë janë pajtuar me të akuzuarin. Të akzuarit i vie keqë për rastin që ka ndodhur, të dëmtuarve iu kërkon falje, është hera e parë që i njëjti ka rënë ndesh me ligjin, premtion se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë veprë tjetër penale si dhe faktin se të dëmtuarit nuk i bashkangjiten ndjekjes penale kundër të akzuarit. Andaj të gjitha këto rrethana bëjnë që ndaj të akzuarit gjykata të shqiptojë një dënim sa më të butë, mundësisht dënim me kusht i cili dënim do të ndikonte mjaft tek i akuzuari dhe me këtë dënim me siguri do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë me ligj. Nëse gjykata vendos që të akzuarit ti shqiptojë dënimin me burg për këtë veprë penale deri në 6 muaj, atëherë të njëjtit dënim ti zëvendësohet me dënim me gjobë me të cilin dënim me siguri do të arrihet qëllimi i paraparë ligjor.

Po ashtu i propozon gjykatës së që mos aprovojë propozimin e prokurorisë së shtetit sa i përket shqiptimit të dënimit plotësues me ndalim të drejtimit të automjetit.

I akuzuari A.H., në fjalën përfundimtare deklaroi, e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, e pranon fajësinë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i premtion gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra penale apo të tjera, të tilla, i vie keq për rastin që ka ndodhur, edhe ai nuk e ndjen vetën mirë me shëndet nga ndikimi i aksidentit, ka marrë trauma, të dëmtuarve iu kërkojë falje dhe i vjen mirë që tani të dëmtuarve ka filluar që tui përmirësohet shëndeti i tyre. Andaj kërkon nga gjykata që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë së dënimit të ketë parasysh edhe gjendjen e tij të vështirë ekonomike në të cilën jeton, sepse si mbajtës i familjes dhe prind i dy fëmijëve të mitur jeton vetëm nga penzioni i veteranit dhe mundësisht t'i shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit.

Gjykata me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akzuarit për këtë veprë penale të kryer, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Për këtë rast si rrethana lehtësuese pati parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën jeton, shprehjen e keqardhjes për rastin që ka ndodh dhe kërkim faljen të dëmtuarve. Andaj duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata, po ashtu vlerësoi se edhe me këtë dënim, do të arrihet qëllimi i dënimit, si dhe do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akzuarit që në të ardhmen të mos kryej vepra penale të këtilla apo të ngjashme.

Në bazë të nenit 59, paragrafi 2, pika 2.5 dhe nenit 64 të KPRK-së, të akuzuarit A. H., i shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit në territorin e Republikës së Kosovës, në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, koha e kaluar në burg nuk i llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi .

Të dëmtuarit: Njazi Istrefaj, Fitim Istrfaj dhe Naim Istrefaj, të gjitha nga fshati Llabjan, komuna e Novobërdës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 452 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, 20€ në emër të ekspertizës mjeko ligjore, si dhe 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2023:227543, 15.04.2024**

**G j y q t a r i,**

**Sadri Krasniqi,d.v.**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.